



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT

Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve Dhe Monitorimit Të Investimeve

RELACION

**PËR MIRATIMIN E DRAFT-KONTRATËS ME QËLLIM PERDORIMIN I PRONES PËR ZBATIMIN TË PROJEKTIT "RESTAURIMI I PEIZAZHIT HISTORIK URBAN TË SHESHIT TË SELAMLLËKUT.**

Në kuadër të programit buxhetor "Infrastruktura Vendore Rajonale", financuar nga buxheti i shtetit, në përputhje me parashikimet e ligjit 88/2019 "Për buxhetin e vitit 2020", nga FSHZH, bazuar në kërkesën e përcjellë nga Bashkia Berat, ka vendosur të realizojë projektin "Restaurimi i Peizazhit Historik Urban të Sheshit të Selamllëkut-Berat".

Bashkia Berat në kuadër të rivitalizimit të një zone të një rëndësie të vecantë kulturore, do të realizojë këtë projekt në një zonë e cila së fundmi është rivitalizuar me ndërhyrjen e prishjes së godinës së shkollës nëntëvjeçare dhe ky rivitalizim do të vijoj me restaurimin e të gjithë peizazhit urban të Sheshit të Selamllëkut. Shesh i cili do të përdoret si hapësirë urbane. Ky shesh është pronë private dhe për këtë arsye Bashkia do të niste procedurat ligjore të shpronësimit të pasurisë pronë private e cila preket nga realizimi i këtij projekti. Në kushtet kur pronarët e truallit në negociata me Bashkinë Berat shprehën dakortësinë e tyre për të dhënë në përdorim këtë pronë me qëllim realizimin e projektit pa kundërshpërblim, për realizimin e këtij projekti nuk do të zhvillohen procedurat sipas ligjit për shpronësimet por procedurat sipas Kodit të Procedurës Civile. Bashkia merr përsipër të përdor pronën sipas qëllimit të projektit duke mos e tjetërsuar atë, ndërsa pronarët në këtë formë i mundësojnë bashkisë përdorimin e truallit pa kosto ekonomike.

Për këtë qëllim ndërmjet Bashkisë Berat dhe pronarëve të pasurisë së llojit "truall", pasuri në të cilën do të realizohet investimi, duhet të nënshkruhet një kontratë e cila do të mundësoj realizimin e Projektit "Restaurimi i Peizazhit Historik Urban të Sheshit të Selamllëkut-Berat".

Objekti i kësaj kontrate është vendosja e një sigurimi ndërmjet palëve nënshkruese me qëllim përdorimin e pronës për zbatimin me sukses dhe përfundimin e projektit "Restaurimi i Peizazhit Historik Urban të Sheshit të Selamllëkut-Berat".

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8, neni 9, pika 1.2 shkronja "a", pika 1.6 shkronja "a", nenit 54 të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 6, pika 2, neni 7 shkronja "dh", kërkohet miratimi nga Këshilli Bashkiak i draft-kontratës ndërmjet Bashkisë Berat dhe pronarëve të pasurisë pronë private që preken nga realizimi i këtij investimi të rëndësishëm për interesin publik.

Faleminderit!

**DREJTORI**  
**Luçiano Bojaxhiu**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT  
KËSHILLI BASHKIAK BERAT

**PROJEKT-VENDIM**

Për Miratimin e Draft-Kontratës me qëllim përdorimin i pronës për zbatimin të Projektit “Restaurimi i Peizazhit Historik Urban të Sheshit të Selamllëkut.

Në mbështetje të nenit 7, pika 2 , nenit 8, neni 9, pika 1.2 shkronja “a” , pika 1.6 shkronja “a”, nenit 54 të ligjit nr.139/2015,“Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 6, pika 2 , me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Drejtorisë së Planifikimit Urban, Lejeve Dhe Monitorimit Të Investimeve:

**VENDOSI :**

1. Për Miratimin e Draft-Kontratës me qëllim përdorimin e pronës për zbatimin e Projektit “Restaurimi i Peizazhit Historik Urban të Sheshit të Selamllëkut.
2. Me ndjekjen e zbatimit e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë Berat dhe Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve Dhe Monitorimit Të Investimeve dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave.

**KRYETAR**

**I KËSHILLIT BASHKIAK**

Ervin CECA